

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.19/2019	Data: 28.02.2019	

Kuvendi i Komunës së Istogut, në pajtim me nenin 34.2. të Statutit të Komunës, 01Nr.55/14 dhe nenit 10 paragrafi 4 të Rregullore për Punën e Kuvendit të Komunës së Istogut Nr. 3/2014, në mbledhjen e mbajtur me 28.02.2019, shqyrtoi Projekt-Rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor dhe mori këtë:

V E N D I M SHPALLJA NË DISKUTIM PUBLIK

1. Hapet diskutimi publik për Projekt-Rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor.
2. Diskutimi publik për projekt-rregulloren e cekur më lartë, do të jetë i hapur prej 28.02.2019 deri më 13.03.2019.
3. Projekt-Rregullorja është e ekspozuar në Sallën e Kuvendit të Komunës, në Istog, për çdo ditë pune prej orës 08⁰⁰ deri në orën 16⁰⁰.
4. Inkurajohen dhe ftohen të gjithë qytetarët, personat juridik dhe shoqatat civile në territorin e Komunës së Istogut, që t'i parashtrojnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në këtë projekt-rregullore brenda kohës dhe afatit të përcaktuar në pikën II. të këtij Vendimi.
5. Për çdo informatë të interesuarit mund t'i drejtoheni Asistentes së KK-së, zyra nr. 305 kati III, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.
6. Ky Vendim të shpallet: në tabelën e shpalljeve, në mjetet e informimit elektronik dhe në Ueb faqen e Komunës së Istogut, me qëllim të njoftimit të qytetarëve të Komunës së Istogut.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.